Sistemi e-Student

Manual përdorimi

2022

# 1 Permbajtja

1 Hyrje ........ 2
2 Logini në sistem ........ 3
3 Faqja e regjistrimit në provime ........ 4
4 Faqja e kërkesave për përmirësim ........ 5
5 Faqja Informacion studenti ........ 6
7 Faqja e ankimimit të notave ........ 8
6 Faqja Financat e studentit ........ 10

# 2 Hyrje

Ky manual do të shërbejë si udhëzues për studentët e Universitetit të Tiranës  në varësi të fakultetit, degës dhe ciklit që bëjnë pjesë. Studentët mund të logohen në sistem me anë të kredencialeve të e-albania-s. Studentët në sistem mund të realizojne: veprimet e mëposhtme:

- Regjistrimin në provime
- Kërkesat për përmirësim
- Mundesinë për te parë të dhenat personale të tyre, te dhenat mbi rregjistrimin në programe, listën e notave dhe historikun e regjistrimit në provime.
- Realizimin e ankimimit të notave
- Mundësinë për të pare të dhënat financiar dhe tarifat sipas programeve që ka ndjekur dhe viteve akademike përkatëse.

# 3 Logini në sistem

Për t'u loguar në sistem studenti duhet të klikojë *'Identifikim nëpërmjet e-albania'*, pastaj mund të vendosë kredencialet e llogarisë së tij në e-albania. Pasi janë plotësuar saktë kredencialet në klikim të butonit "*Hyr*" studenti do mund të logohet në e-Student.






# 4 Faqja e regjistrimit në provime

Në këtë faqe studenti mund të realizojë regjistrimin në provimet e çelura për sezonin përkates. Në faqe shfaqet lista me provimet e çelura për sezonin së bashku me të dhënat kryesore ku përfshihen: Lënda, kreditet , data e provimit , salla , komente dhe statusi.

Nëse studenti është regjistruar njëherë në provim atehere statusi është ' i regjistruar' dhe studenti mund të ç'regjistrohet duke klikuar butonin e ç'regjistrimit.




Studenti mund të marë informacion të detajuar në lidhje me provimin duke klikuar butonin e informacionit, ku mund të shohë dhe afatin që ka për tu regjistruar në provim.



# 5 Faqja e kërkesave për përmirësim

Në këtë faqe studenti mund të bëjë kërkesa për përmirësim për lëndët në të cilat ka mare vlerësime përfundimtare. Kjo realizohet duke perzgjedhur lendët që dëshiron të japë për përmirësim dhe duke klikuar butonin '*Kërko Përmiresim'*.




Në klikim të butonit të informacionit studenti mund të marë informacion të detajuar në lidhje me proçesin e kërkesave për përmiresim.



# 6 Faqja Informacion studenti

Në këtë faqe, studenti mund të shohë të gjitha informacionet personale te tij, programet studimore, listën e notave dhe historikun e regjistrimit në provime.

- Informacion personal




- Informacion në lidhje me rregjistrimin në programet studimore, studenti mund të filtrojë sipas programit studimor



- Informacion në lidhje me listën e notave, studenti mund të kërkojë sipas programit studimor, në rastin kur ka ndjekur më shumë se një program. Gjithashtu informacioni mbi notat mund ta kërkojë edhe sipas viteve akademike.




| Nr | Lëndet / Modulet | Kreditet | Nota |
|---|---|---|---|
| 1 | Algoritmikë | 6 | 8 |
| 2 | Matematikë 1 | 6 | 8 |
| 3 | Hyrje në Ekonomi | 5 | 9 |
| 4 | Hyrje në Informatikë | 7 | 6 |
| 5 | Programim në C++ | 5 | 7 |
| 6 | Gjuhë e huaj 1/1 (Anglisht) | 3 | 10 |
| 7 | Matematikë 2 | 5 | 9 |
| 8 | Marketing | 4 | 7 |
| 9 | Struktura e të dhënave | 6 | 9 |
| 10 | Menaxhim | 4 | 8 |
| 11 | Multimedia | 5 | 10 |
| 12 | Gjuhë e huaj 1/2(Anglisht) | 3 | 8 |
| 13 | Matematikë e Zbatuar | 6 | 7 |
| 14 | Mikroekonomi | 6 | 10 |
| 15 | Arkitekturë kompjuteri | 6 | 7 |
| 16 | Bazat e Statistikës | 6 | 9 |

- Informacion në lidhje me historikun e provimeve të kryera ose atyre që duhet të kryejë duke filtruar sipas programit.




| Nr. | Lënda/Moduli | Kredite | Dt. provimi | Ora | Salla | Nota | Shkronja | Statusi | Nuk është paraqitur | Nuk ka përmbushur detyrimet | Përmirësim | Ekuivalent |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Algoritmikë | 6 | 01/12/2021 | 00:00 | | 8 | Tetë | | | | | |
| 2 | Matematikë 1 | 6 | 01/12/2021 | 00:00 | | 8 | Tetë | | | | | |
| 3 | Hyrje në Ekonomi | 5 | 01/12/2021 | 00:00 | | 9 | Nëntë | | | | | |
| 4 | Hyrje në Informatikë | 7 | 01/12/2021 | 00:00 | | 6 | Gjashtë | | | | | |
| 5 | Programim në C++ | 5 | 01/12/2021 | 00:00 | | 7 | Shtatë | | | | | |
| 6 | Gjuhë e huaj 1/1 (Anglisht) | 3 | 01/12/2021 | 00:00 | | 10 | Dhjetë | | | | | |
| 7 | Matematikë 2 | 5 | 01/12/2021 | 00:00 | | 9 | Nëntë | | | | | |
| 8 | Marketing | 4 | 01/12/2021 | 00:00 | | 7 | Shtatë | | | | | |
| 9 | Struktura e të dhënave | 6 | 01/12/2021 | 00:00 | | 9 | Nëntë | | | | | |
| 10 | Menaxhim | 4 | 01/12/2021 | 00:00 | | 8 | Tetë | | | | | |
| 11 | Multimedia | 5 | 01/12/2021 | 00:00 | | 10 | Dhjetë | | | | | |
| 12 | Gjuhë e huaj 1/2(Anglisht) | 3 | 01/12/2021 | 00:00 | | 8 | Tetë | | | | | |
| 13 | Matematikë e Zbatuar | 6 | 01/12/2021 | 00:00 | | 7 | Shtatë | | | | | |

# 7 Faqja e ankimimit të notave

Në këtë faqe shfaqen lëndët në të cilat studenti ka marrë vleresimet paraprake nga pedagogu,pra provimi është në fazën kur lejohen ankimimet. Studentët mund të bëjnë kërkesat për ankimim note, përgjatë afatit të përcaktuar.

Studenti mund të filtrojë sipas statusit: Pa ankimim, ankimuar dhe kthyer pergjigje.




Studentët mund të marin informacion më të detajuar duke klikuar butonin e informacionit .



Në klikim të butonit që ndodhet në tabelë mund të realizojnë ankimimin  I cili hap faqen e mëposhtme.




Në momentin e dërgimit kërkesa I dërgohet pedagogut dhe studenti duhet të presë përgjigjen. Në momentin që I kthehet përgjigje studentit I vjen pergjigjia që ka kthyer pedagogu.

Studenti mund të shohë nëse pedagogu ka ndryshuar notë, dhe komentin përkatës që ka bërë.



# 8 Faqja Financat e studentit

Në këtë faqe studenti mund të shohë pagesat që ka realizuar në lidhje me tarifat e shkollimit. Studenti ka mundësinë e kërkimit të tarifës sipas programeve dhe viteve akademike. Të dhënat që mund të shohë studenti janë:

1. Shuma që duhet të paguajë
2. Lloji I monedhës
3. Datën e shtimit të tarifës
4. Ka reduktim tarife ose jo, nëse studenti ka ulje në tarifë mund të shohë edhe arsyejen e uljes
5. Vlerën që studenti ka paguar

